



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUALE**  
**PA1 Nr. 0802-89**  
**15.03.2024**  
**Shkup**

Në pajtim me nenin 18, paragrafi (1), nënparagrafi 2, nenin 82, paragrafi (1), nënparagrafi 6 dhe nenin 83 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.42/20, 77/21, 154/23 dhe 55/24), dhe në lidhje me nenin 80, paragrafi (5) të këtij ligji, neni 51 paragrafi (1) dhe paragrafi (3) dhe neni 52 paragrafi (2) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.124/15), neni 28 nga Ligji i Kontesteve Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr.96/19), neni 24 i Rregullores për procedurat e punës financiare dhe kontabilitetit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale me nr. ark.01-6222/1 datë 12.12.2014, duke vepruar sipas propozimit PA1 nr.0803-89 datë 29.2.2024, për inicim të procedurës për heqjen dhe propozimin PA1 nr.0803-89 datë 14.3.2024 për miratim të vendimit për heqjen e lejes së radiotransmetimit të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, në pajtim me konkluzionin, ark.nr.0201-1235/2 datë 15.3.2024, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 10-të, mbajtur më 14.3.2024, miratoi:

**VENDIM**  
**për marrjen e lejes së radiotransmetimit të**  
**Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO PRO-FM SHPK Gostivar**

1. I HIQET leja e radiotransmetimit PA1 nr.08-95 datë 7.9.2023, Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO PROO-ΦM SHPK Gostivar, për shkak të mospagesës së kompensimit vjetor të lejes së radiotransmetimit në afatin e përcaktuar ligjor prej – 30 ditësh nga dita e pranimit të faturës nr.2024-100-0051 datë 11.1.2024. (nr. ynë ark.0503-225/1 datë 11.1.2024).

2. Fatura nr.2024-100-0051 datë 11.1.2024.(nr.ynë ark.0503-225/1 datë 11.1.2024), i kthehet subjektit sipas pikës 1. të këtij vendimi, i lëshohet (jepet) faturë e re, e cila i referohet vetëm periudhës së punës, gjegjësisht nga dita e miratimit të vendimit për heqjen e lejes, e cila duhet të paguhet jo më vonë se 8 (tetë) ditë nga dhënia e saj.

3. Ky vendim botohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe në ueb-faqen e Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe në dy gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësive joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

4. Ky vendim është përfundimtar.

## **A r s y e t i m**

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) RADIO PRO-FM Gostivar, është zotërues i lejes së radiotransmetimit, PA1 nr.08-95 datë 7.9.2023, për transmetim nëpërmjet transmetuesit tokësor, në nivel lokal, për zonën e komunës së Gostiverit, shërbim programor radiomuzikor me format të përgjithshëm, në gjuhën shqipe.

Në pajtim me nenin 80 paragrafi (1) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), për lejen e transmetimit në televizion ose radio transmetuesim me përjashtim të shërbimit publik radiodifuziv, paguajnë kompensim (tarifë) vjetore në llogari të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) në pajtim me ligjin. Kompensimi vjetor paguhet për çdo vit aktual, duke filluar nga data e dhënies (lëshimit) të lejes për transmetim në televizion ose radio në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë (lëshuar) nga Agjencia (neni 80 paragrafi 5 të LSHMAAV).

Në lidhje me kompensimin e lejes për radiotransmetim të SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, PA1 nr.08-95 datë 7.9.2023, Agjencia më 11.1.2024 dërgoi faturë me nr.2024-100-0051 datë 11.1.2024 (nr. ynë ark.0503-225/1 datë 11.1.2024) për kompensimin e lejes, në pajtim me të cilën transmetuesi kishte detyrim të paguante 32.084,00 (tridhjetë e dy mijë e tetëdhjetë e katër) denarë për kompensim vjetor për lejen e radiotransmetimit, për periudhën prej 5.1.2024 deri më 4.1.2025. Duke pasur parasysh faktin se edhe pas dy përpjekjeve të kryera transmetuesi nuk e ka pranuar faturën e dorëzuar me shkrim, po e njëjta i është dorëzuar dhe në formë elektronike më datë 29.1.2024, në adresën elektronike të regjistruar si informacion për kontakt në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në pajtim me nenin 27 paragrafi (1) të LSHMAAV, Agjencia kryen mbikëqyrje administrative, i cili kryhet mbi punën e botuesve të medias nga aspekti i harmonizimit të punës së tyre me kushtet e përcaktuara në Ligjin për Media, LSHMAAV dhe rregullorat e miratuara në bazë të tij (neni 29 paragrafi 1 të LSHMAAV).

Agjencia, nëpërmjet Sektorit të financave dhe logjistikës, ka kryer mbikëqyrje administrative të punës së SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, nga aspekti i përmbushjes së detyrimit për pagesën e kompensimit vjetor për leje, ku nga përfundimi i mbikëqyrjes së rregullt administrative, në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative (nr. ynë ark.0503-1048/1 datë 29.02.2024), u konstatua se transmetuesi në fjalë nuk e ka përmbushur detyrimin ligjor të përcaktuar në nenin 80 paragrafi (5) të LSHMAAV, gjegjësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor të lejes për radiotransmetim në llogari të Agjencisë.

Gjegjësisht, sipas faturës së dorëzuar nr.2024-100-0051 datë 11.1.2024. (nr. ynë ark.0503-225/1 datë 11.01.2024), SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, ka pasur detyrim të paguajë 32.084,00 (tridhjetë e dy mijë e tetëdhjetë e katër) denarë për kompensim vjetor për lejen për radiotransmetim për periudhën nga 5.1.2024 deri më 4.1.2025 që nga 27.02.2024 që ishte afati i fundit ligjor për pagesën e kompensimit të SHTR RADIO PRO-FM Gostivar, nuk ka kryer pagesë në shumë prej 32.084,00 (tridhjetë e dy mijë e tetëdhjetë e katër) denarë.

Në nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 3 të LSHMAAV, është përcaktuar se nëse konstatohet mosrespektim, cenim ose shkelje të dispozitave të LSHMAAV dhe të akteve nënligjore, të miratuara me ligj, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë, kundër botuesit të medias, Këshilli i Agjencisë mund të marrë masa – marrjen e lejes.

Në pajtim me nenin 82 paragrafi (1) nënparagrafi 6 të LSHMAAV, Agjencia do të marrë lejen për transmetim në televizion ose radio, para skadimit të afatit për të cilën është dhënë (lëshuar) dhe do të fshijë transmetuesin nga regjistri i radiodifuzerëve, me dorëzim paraprak të njoftimi me shkrim, nëse zotëruesi i lejes nuk e ka paguar kompensimin për lejen në afatin e përcaktuar ligjor.

Procedua për marrjen e lejes për transmetim në televizion ose radio, në pajtim me nenin 83 paragrafi (1) të LSHMAAV, e inicon Këshilli me propozim të drejtorit të Agjencisë.

Duke pasur parasysh gjendjen faktike të konstatuar, në pajtim me të cilin zotëruesi i lejes, SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, në afatin e parashikuar ligjor prej 30 ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga Agjencia, nuk ka përmbushur detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të LSHMAAV, gjegjësisht zotëruesi i lejes nuk e pagoi kompensimin vjetor për lejen e radiotransmetimit në afatin e përcaktuar ligjor, drejtori i Agjencisë, në bazë të nenit 83 paragrafi (1), dhe në lidhje me nenin 82 paragrafi (1) nënparagrafi 6 të LSHMAAV, dorëzoi Propozim PA1 nr.0803-89 datë 29.2.2024 për iniciimin e procedurës për marrjen e lejes së transmetimit të radios të SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar.

Këshilli i Agjencisë në seancën e 8-të, mbajtur më 1.3.2024, në pajtim me Konkluzionin me ark.nr.0201-1054/10 datë 01.03.2024, e miratoi Propozimin PA1 nr.0803-89 datë 29.2.2024, për iniciimin e procedurës për marrjen e lejes së transmetimit të radios të SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar.

Në lidhje me procedurën e inicuar për marrjen e lejes për transmetim të radios të SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, PA1 nr.08-95 datë 7.9.2023, dhe në pajtim me nenin 82 paragrafi (1) të LSHMAAV, Agjencia i dërgoi njoftim transmetuesit në fjalë, (PA1 nr.0803-89 datë 04.03.2024), në të cilën theksohet se nëse nuk e paguan kompensimin vjetor për lejen për kryerje të radiotransmetimit në pajtim me nenin 83 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga pranimi i Propozimit për iniciimin e procedurës për marrjen e lejes, PA1 nr.0803-89 datë 29.02.2024, do të marrë vendim për marrjen e lejes së tij për transmetim të radios, pas së cilës në pajtim me nenin 85 paragrafi (2) të LSHMAAV, transmetuesi do të fshihet nga regjistri i transmetuesve.

Njoftimi PA1 nr.0803-89 од 04.03.2024, i është dërguar SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar me shkrim me postë rekomanduese. Duke pasur parasysh faktin, se drejtuar Agjencisë deri në momentin e marrjes së këtij Vendimi, nuk është dorëzuar letër kthyese nga SH.A. Posta e RMV-së për pranim të Njoftimit (PA1 nr.0803-89 datë 4.3.2024), Agjencia ka kryer kontroll në sistemin elektronik – ndjekja e dërgesave të SH.A. Posta e RMV-së përmes së cilës kontrollohet statusi i dërgesës, nga ku është konstatuar se për njoftimin në fjalë, akoma nuk ka siguruar fakt për dorëzim të dërgesës së pranuesit.

Kjo, më 11.3.2024 është dorëzuar dhe në formë elektronike në adresën elektronike oficiale të transmetuesit të regjistruar si informacion për kontakt në RQRMV-së dhe në regjistrimin e transmetuesve që udhëhiqet nga Agjencia..

Në pajtim me nenin 83 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli është i detaruar që në afat prej 15 ditësh nga pranimi i propozimit të drejtorit, të fillojë procedurën për marrjen e lejes, të miratojë vendim me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit.

Duke pasur parasysh faktin e verifikuar se zotëruesi i lejes SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, PA1 nr.08-95 datë 07.09.2023 dhe në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të Propozimit PA1 nr.0803-89 datë 29.2.2024 nga ana e anëtarëve të Këshillit të Agjencisë, nuk e ka përmbushur detyrimin e përcaktuar në nenin 80 paragrafi (5) të LSHMAAV, drejtori i Agjencisë, dorëzoi Propozimin PA1 nr.0803-89 datë 14.3.2024 sipas të cilit Këshilli i Agjencisë në bazë të nenit 82 paragrafi (1) nënparagrafi 6 dhe neni 83 paragrafi (3) të LSHMAAV, dhe në pajtim me Konkluzionin e Agjencisë, me nr.ark.0201-1235/2 datë 15.3.2024, miratoi vendim me të cilën i mirret leja PA1 nr.08-95 datë 7.9.2023 për radiotransmetim të SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, për shkak se zotëruesi i lejes nuk e ka përmbushur detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të LSHMAAV,

gjegjësisht nuk e ka paguar kompensimin vjetor të lejes së radiotransmetimit në afatin e përcaktuar ligjor.

Në pajtim me nenin 24 të Rregullores së procedurave të punës financiare dhe kontabilitetit të Agjencisë, nëse zotëruesi i lejes së transmetimit në televizion ose radio nuk kryen pagesën e kompensimit, sipas faturës së dorëzuar në afatin e cekur në paragrafin (3) të këtij ligji të Rregullores, po e njëjta kthehet dhe i jipet faturë e re e cila i referohet vetëm periudhës së punës, e cila pagohet jo më vonë se 8 (tetë) ditë nga dita e dhënies (lëshimit) të saj. Në të kundërtën pagesa e borxhit, do të kryhet në rrugë gjyqësore.

Rrjedhimisht, nga kjo që u theksua më sipër, fatura nr.2024-100-0051 datë 11.01.2024 (nr.y në ark.0503-225/1 datë 11.01.2024) për kompensimin e lejes për radiotransmetim, kthehet dhe SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, i jipet (lëshohet) faturë e re, e cila i referohet periudhës së punës, gjegjësisht nga dita e miratimit të këtij vendimi për marrjen e lejes dhe që duhet të paguhet jo më vonë se 8 (tetë) ditë nga dhënia e saj.

Në pajtim me nenin 84 të LSHMAAV, vendimi për marrjen e lejes për transmetim në radio është përfundimtar, ndërkaq kundër tij, zotëruesi i lejes ka të drejtë që të parashtojë padi për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditëve nga pranimi i tij. Procedura para gjykatës kompetente është urgjente.

Në bazë të gjithë kësaj që është theksuar më lartë, u mor vendim si në dispozitiv.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI,d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi për marrjen e lejes për radiotransmetim, SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente në aft prej 30 ditësh nga pranimi i tij.